

VENDIM
Nr. 361, datë 30.5.2012

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 41/2012 “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit e administrimit të shoqërive huamarrëse është si më poshtë vijon:

a) Paga e administratorit të shoqërive huamarrëse barazohet me pagën e funksionit “drejtor drejtorie në ministri” dhe klasifikohet në nivelin II-b.

b) Paga e specialistit barazohet me pagën e funksionit “specialist i nivelit të dytë” dhe klasifikohet në nivelin IV-a.

Vlera përkatëse e pagës për çdo kategori dhe përllogaritja e pagës bruto mujore bëhet në përputhje me pikën 2 të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit.”.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit mbështetës të administrimit të shoqërive huamarrëse janë të njëjta me ato të punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe llogariten në përputhje me vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për administratorin hyjnë në fuqi nga data e emërimit të tij, ndërsa për punonjësit e tjerë pas miratimit të strukturës dhe përballohen nga të ardhurat e shoqërive.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha